



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 11.07.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e udhëzuesit “Për mënyrën e përdorimit të teknologjisë audiovizive në procesin gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. (Çështje e shtyrë nga mbledhja plenare e datës 24.01.2024).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 12:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 10. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Irena Plaku**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.**
- 4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Edmond Hoxhaj, Birn.**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e udhëzuesit “Për mënyrën e përdorimit të teknologjisë audiovizive në procesin gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. (Çështje e shtyrë nga mbledhja plenare e datës 24.01.2024).

Çelet mbledhja plenare e Këshillit të Lartë Gjyqësor datë 11.07.2024. Rendi i ditës disa çështje që janë me dyer të hapura dhe disa çështje me dyer të mbyllura.

Naureda Llagami: Pa humbur kohë po fillojmë me çështjen e parë e cila në fakt është miratimi i udhëzuesit “Për mënyrën e përdorimit të teknologjisë audiovizive në procesin gjyqësor”. Kjo çështje ka qenë në rendin e ditës, por në mbledhjen plenare u vendos që ky udhëzues t’i kalojë edhe një herë për mendim trupës gjyqësore dhe nga informacioni që kam nga administrata, udhëzuesi i është nënshtruar edhe një herë konsultimit trupës gjyqësore, të cilat ne i kemi marrë parasysh të gjitha ato sugjerime që

2

na kanë përçuar trupa gjyqësore. Kështu që unë pa humbur kohë ia jap fjalën fillimisht Drejtorit të Departamentit të Administrimit Gjyqësor dhe Teknologjisë për të na i referuar shkurtimisht ku është qëllimi i këtij udhëzuesi.

Kelment Greca: Përshëndetje të nderuar anëtarë!

Po risjellim edhe një herë projektvendimin për një udhëzim për mënyrën e përdorimit të teknologjisë audiovizive në proceset gjyqësore. Ky projekt-udhëzim është mbështetur në nenin 94, pika 4/g, ligji 115 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ku parashikon që Këshilli miraton rregulla standarde për eficientë e drejtësisë që përfshijnë parashikime për: g) udhëzues për mënyrën e përdorimit të teknologjisë audiovizive në procesin gjyqësor.

Pas mbledhjes së Këshillit, ky udhëzim u shpërnda për mendim të gjitha gjykatave dhe gjykatat që kanë sjellë mendim janë Gjykata Administrative e Apelit, është Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë dhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Të gjithë mendimet e gjykatave ne i kemi reflektuar tek projekt-udhëzimi. Kryesisht ato që referojnë gjykatat kanë të bëjnë në lidhje me procesverbalin, transkriptin që do t’i japin palëve, dhe të gjithë kanë dalë në konkluzionin që palët të marrin vetëm në audio (jo në video). Kjo është reflektuar tek udhëzimi. Kështu që, palët që do të kërkojnë transkriptim, do i jepet vetëm në audio. Video do jetë vetëm përdorim i brendshëm për gjykatën dhe për zbardhjen e procesverbalit të brendshëm të gjykatës dhe për të kërkuar nga shkallët e tjera të gjyqësorit.

Projektvendimi ka dy pika, është miratimi dhe ngarkimi për të gjitha gjykatat për zbatimin e këtij vendimi.

Projekt-udhëzimin e keni bashkëngjitur.

Projekt-udhëzimi ka edhe një udhëzues përdorues. Kjo është nga prodhuesi i projektit që është “FTR Reporter”, që është pjesë e këtij udhëzimi. Është një manual përdorimi për të gjithë përdoruesit e sistemit të regjistrimit audioviziv në gjykatë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Kemi ndonjë diskutim?

Po, Alban?

Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit?

Ilir Rusi: Dakord.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi

1. Miratimin e udhëzimit “Për mënyrën e përdorimit të teknologjisë audio/audi vizive në procesin gjyqësor” sipas tekstit bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohen të gjitha gjykatat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 11.07.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullores “Për përdorimin e postës elektronike zyrtare në KLGJ dhe sistemin gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. (Çështje e shtyrë nga mbledhja plenare e datës 24.01.2024).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 12:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Markelian Koça*** (anëtar)
9. ***Yllka Rupa*** (anëtare)
10. ***Emona Muçi*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.**
- 4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Edmond Hoxhaj, Birn.**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullores “Për përdorimin e postës elektronike zyrtare në KLGJ dhe sistemin gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. (Çështje e shtyrë nga mbledhja plenare e datës 24.01.2024).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës. Edhe ky është pjesë e rregullimeve që ne kemi marrë lidhur me përdorimin e postës elektronike zyrtare në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në sistemin gjyqësor.

Ju rikujtoj që Këshilli ka marrë një vendim në të cilin posta elektronike tashmë është pjesë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk është më e ankoruar pranë AKSH-it. Në vijimin e këtyre vendimeve, aktet plotësojnë të gjithë kuadrin rregullator në përdorimin e postës zyrtare.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap sërish drejtorit. Edhe për këtë akt i është nënshtruar konsultimit të trupës gjyqësore, për të dytën herë në fakt. Kemi kërkuar

komente, por me thënë të vërtetën nuk na ka ardhur ndonjë koment. Kështu që në kuadrin e rregullimit të mënyrës së përdorimit, e gjej me vend që ne këtë akt ta miratojmë dhe nëse do kemi komente apo sugjerime në të ardhmen, patjetër, mund të jenë pjesë e reflektimit të ndryshimeve.

Atëherë, unë do ia jap fjalën drejtorit, i cili ka bërë një konsolidim të aktit me të gjithë sugjerimet që kanë pas kolegët brenda nesh, ndërkohë që nga trupa nuk kemi pasur. Nëse na vijnë, prapë këtu jemi, e shohim dhe e përmirësojmë aktin.

Kelment Greca: Përshëndetje!

Atëherë, si edhe referoi Kryetarja, ky është një akt i dërguar sërish pranë gjykatave, për të marrë mendimin e tyre mbi këtë projekt-akt. Nga gjykatat nuk erdhi asnjë mendim. Kemi konsoliduar me anëtarët e Këshillit, kryesisht me z. Toro, kemi konsoliduar aktin, kemi bërë disa rregullime. Kemi saktësuar disa kritere të sigurisë. Ne po miratojmë edhe një projektvendim në lidhje me sigurinë kibernetike që do jetë pjesë tjetër e vendimmarrjes së Qendrës së Teknologjisë së Informacionit, prandaj po e risjellim edhe një herë aktin të përmirësuar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, atëherë kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e rregullores “Për përdorimin e postës elektronike zyrtare në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Sistemin Gjyqësor” sipas tekstit bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohen Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe gjykatat e të gjitha niveleve për zbatimin e këtij vendimi.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 11.07.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të këshilltares ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 12:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Markelian Koça*** (anëtar)
9. ***Yllka Rupa*** (anëtare)
10. ***Emona Muçi*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.**
- 4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Edmond Hoxhaj, Birn.**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të këshilltares ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të këshilltares ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë znj. {...}”. Për më shumë detaje fjalën ia jap zonjës Luli.

Fatmira Luli: Faleminderit!

Zonja {...} ka depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, kërkesën datë 01.07.2024, protokolluar me tonën nr. {...} prot., datë 01.07.2024, me anë të së cilës parashtron kërkesë për dorëheqje nga detyra e Këshilltarit Ligjor pranë Njësisë së Shërbimit Ligjor, në Gjykatën e Lartë, referuar ligjit nr. 98/2016 ”Për organizimin e

pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 289, datë 05.06.2024 “Mbi miratimin e rregullores “Për pezullimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Bazuar në të dhënat që disponon Drejtoria e Burimeve Njerëzore, znj. {...}, nëpunës civil gjyqësor, referuar ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në pozicionin Këshilltar Ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë, e datëlindjes 09.02.1963, në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbush moshën për pension të plotë pleqërie më datë 09.10.2024. Megjithatë, znj. {...} paraqet kërkesën e ligjshme, referuar vendimit nr. 289, datë 05.06.2024 “Mbi miratimin e rregullores “Për pezullimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këshilli, mbështetur në nenin 80 të ligjit nr. 98/2016 ka në kompetencë të tij, ndër të tjera, ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor për pozicionin e këshilltarit ligjor. Në nenin 12, pika 1 e vendimit nr. 289, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përcaktohet se: “1. Marrëdhënia e shërbimit civil gjyqësor ndërpritet me vendim të: a) Këshillit të Lartë Gjyqësor për Kancelarin, Këshilltarin dhe Ndhmësin Ligjor”.

Referuar nenit 16 të vendimit nr. 289, përcaktohet se: “Nëpunësi civil gjyqësor mund të njoftojë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes me shkrim tek Këshilli i Lartë Gjyqësor për Kancelarët, Këshilltarët dhe Ndhmësit Ligjor dhe tek Këshilli i Gjykatës për nëpunësit e tjerë. 2. Dorëheqja nuk motivohet dhe i prodhon efektet 30 ditë nga data e paraqitjes së saj. 3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar të nëpunësit civil gjyqësor dhe me miratimin e organeve kompetente të përcaktuara sipas pikës 1 të këtij neni, dorëheqja i prodhon efektet përpara afatit 30-ditor nga njoftimi. 4. Nëpunësit civilë gjyqësorë, të cilët janë larguar nga shërbimi civil gjyqësor si pasojë e dorëheqjes, kanë të drejtë që të konkurrojnë si nëpunës civilë gjyqësorë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas ligjit “Për nëpunësit civil”, deri në 2 vjet pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor”. Referuar kësaj dispozite, rezulton se një ndër rastet e përfundimit për shkak të ligjit, të marrëdhënies në shërbim civil gjyqësor, është paraqitja e kërkesës së dorëheqjes me shkrim.

Sa më sipër, mbështetur në nenin 80 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 16 vendimit nr. 289, datë 05.06.2024 të rregullores “Për pezullimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe kërkesën e e znj. {...}, vlerësohet përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor në datën... Në fund të muajit? Si do ta lëmë datën?

Sepse efektet i prodhon 30 ditë nga njoftimi.

Atëherë mund ta bëjmë në fund të këtij muaji.

Ta lëmë në fund të muajit, ta lëmë në 30 korrik.

Atëherë projekt-akti që paraqitet për miratim është:

1. Përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, këshilltare ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë, për shkak të dorëheqjes.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më 30.07.2024. 31.07.2024.

Naureda Llagami: 31.

Fatmira Luli: Po!

Një kopje e këtij vendimi i njoftohet zonjës {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe Gjykatës së Lartë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, unë propozoj që ta kalojmë në votim projekt-aktin.

Ilir Rusi: Dakord.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, këshilltare ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë, për shkak të dorëheqjes.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 31.07.2024.

3. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar dhe Gjykatës së Lartë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 11.07.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për periudhën 2020-2022”, relatore znj. Yllka Rupa.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 12:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 10. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Edmond Hoxhaj, Birn.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për periudhën 2020-2022”, relatore znj. Yllka Rupa.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë pa vonesë tek projekt-akti tjetër i cili ka të bëjë me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për periudhën 2020-2022. Relatore është zonja Yllka Rupa.

Yllka Rupa: Faleminderit!

Të nderuar kolegë!

Në cilësinë e relatores po paraqes projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarin {...}. Është periudha e vlerësimit 01.01.2020 – 31.12.2022.

Në projektraport është paraqitur e plotë procedura e vlerësimit sipas hapave që përcaktohen në ligj. Kështu që do të paraqes në mënyrë të përmbledhur rezultatet e vlerësimit për gjithsecilin nga katër kriteret e vlerësimit.

Në bazë të analizës së të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit rezulton se për kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, “Njohuritë ligjore”, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normave konkrete procedurale dhe materiale

që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Propozohet lidhur me këtë nënkriter niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 25.

Në lidhje me “Aftësinë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, në tërësi referuar të dhënave rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo kur ato shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Ndërkohë dispozitat e ligjit material rezultojnë të jenë referuar dhe interpretuar plotësisht dhe duke zbërthyer në elementët përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës, para aplikimit mbi faktet e çështjes konkrete. Po ashtu gjyqtari, tregon një kujdes të veçantë për identifikimin dhe zbatimin e praktikës relevante gjyqësore unifikuese, praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së, si dhe kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e tij lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit, në funksion të konkluzioneve mbi zgjidhjen e çështjeve konkrete.

Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 25.

Në lidhje me “Arsyetimin ligjor”, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtari gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme. Kështu që lidhur me nënkriterin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”, propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 15 për gjyqtarin.

Për sa i takon “Strukturës së qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit gjyqësor”, në tërësi evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij.

Propozohet nivel shumë i lartë vlerësimi dhe pikëzimi.

Lidhur me “Cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik”, ka rezultuar në të gjitha vendimet burim vlerësimi, rezulton nivel shumë i mirë arsyetimi, i detajuar dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të nevojshëm në raport me faktin civil apo penal si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale të gjykimit kryesisht çështje të kompetencës lëndore, të caktimit të barrës së provës, rolit të gjykatës në funksion të vlerësimit të shkakut ligjor të padisë, etj.

Lidhur me këtë nënkriter pra “Cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik”, propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 25.

Kështu që në lidhje me “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, propozohet niveli "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për të kaluar tek “Aftësitë organizative të gjyqtarit”.

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm apo në trup me të tjerët.

Në lidhje me “Aftësinë e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë”, për sa i përket respektimit të afateve ligjore, në tërësi referuar të dhënave që rezultojnë për burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore. Duke iu referuar analizës matematikore e logjike të të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të analizuara në projektraport si dhe duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, vlerësoj se për këtë tregues, gjyqtari z. {...} duhet të pikëzohet me nivel më të lartë pikëzimi se ai që i përket përqindjes prej 22.7% të çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit dhe që në rastin konkret përkon me 9 pikë. Duhet pasur parasysh edhe fakti se pikërisht viti në të cilin gjyqtari ka numrin me të madh të çështjeve për të cilat ligji parashikon afati ligjore gjithashtu dhe numrin me të madh të çështjeve gjykuara jashtë afati ligjorë përkon me periudhën e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të periudhës së pandemisë COVID 2019, me vendim të KLGJ-së, pra ka qenë një periudhë nga data 10.03.2020-22.04.2020, periudhë e pezulluar veprimtaria gjyqësore. Për pikëzimin e këtij treguesi, vlerësuesi bazohet në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, përballë detyrueshmërisë

ligjore që një kategori çështjesh duhet të shqyrtohen brenda afateve të përcaktuara. Duke iu referuar gjithashtu numrit të madh të çështjeve të shqyrtuara nga gjyqtari, gjithsej 1488 çështje për gjithë periudhën e vlerësimit, numri i çështjeve të shqyrtuara tej afatit ligjor përben vetëm 6.2 % të çështjeve në total të përfunduara nga gjyqtari. Kështu që në këto kushte propozoj vlerësimin maksimal të tij lidhur me këtë tregues.

Për të kaluar tek “Plotësimi i standardit minimal kohor”, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, numrit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor, në raport me numrin total të çështjeve, rezulton të jetë një përqindje 15.5%, që në bazë të metodologjisë vlerësohet me 4 pikë; duke pasur në konsideratë edhe faktorët që u përmendën më lart, propozoj rritjen me një nivel të gjyqtarit lidhur me këtë tregues, kështu edhe pikëzimin me 5 pikë.

Për sa i takon “Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, në 10 kategoritë e çështjeve, vetëm në 2 prej tyre koha mesatare tejkalon standardin minimal. Gjyqtari ka shqyrtuar një numër të konsiderueshëm çështjesh që sipas të dhënave statistikore në total janë 1488 çështje. Ajo çfarë ka ndikuar realisht në kohën mesatare të shqyrtimit të çështjeve ka ardhur për shkaqe të përmendura nga vetë gjyqtari në formularin e vetëvlerësimit dhe të pavarura nga vetë ai, siç ka qenë periudha e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore si dhe fakti që me vendimet e KLGJ-së gjyqtari është caktuar të shqyrtojë çështje gjyqësore në gjykata të tjera, konkretisht në gjykata të rretheve gjyqësore Krujë, Lezhë, Mat, Dibër, Tiranë, Durrës, gjatë periudhës së vlerësimit 2020-2022.

Propozohet lidhur me këtë tregues pikëzimi me 5 pikë.

Në lidhje me “Rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore” ka rezultuar ky rendiment në masën 92.36 %. Referuar metodologjisë së pikëzimit, të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundime për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve dhe është bazuar në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai që përcakton metodologjia, deri në pikëzimin maksimal nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës të përcaktuar nga

Këshilli. Ku ka rezultuar se për vitin 2020 ka shqyrtuar në total 323 çështje me palë kundërshtare me një rendiment 161%. Për vitin 2021 ka shqyrtuar në total 328 çështje me palë kundërshtare me një rendiment 164%. Në vitin 2022 ka shqyrtuar në total 268 çështje me palë kundërshtare me një rendiment 134%.

Në këto kushte propozoj që lidhur me këtë tregues gjyqtari të pikëzohet me 10 pikë.

Në lidhje me “Kohën mesatare të arsytimit të vendimit përfundimtar” ka rezultuar më e shkurtër kjo kohë ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, kështu që gjyqtari propozohet të vlerësohet me 15 pikë.

Për sa i takon “Aftësisë për të kryer procedura gjyqësore”, “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive”, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 2.7 seanca dhe gjyqtari në çdo rast ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave. Kështu që në këto kushte propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 15.

Për të kaluar tek “Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale”, rezulton se gjyqtari ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

Propozohet nivel shumë i lartë vlerësimi, pikët 20.

Në lidhje me “Aftësinë për të administruar dosjen gjyqësore”, në komponentin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” rezulton se renditja e akteve të dosjes e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal, aktet janë të numërtuar dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Lidhur me këtë nëntregues propozohet niveli shumë i lartë i vlerësimit, pikët 5.

Lidhur me “Saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes”, ka rezultuar që mungon letra e të drejtave. Kështu që në lidhje me këtë komponent propozohet vlerësimi i gjyqtarit me 8 pikë.

Në lidhje me kriterin “Aftësitë organizative të gjyqtarit”, propozohet niveli "Shkëlqyeshëm", pikët 98.

Për të kaluar tek “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, për të gjithë treguesit e këtij kriteri propozohet niveli maksimal i vlerësimit dhe i pikëzimit për arsye sepse rezulton që gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion, nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojnë etikën në punë të tij.

Në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtarit, prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij.

Gjithashtu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është i pakonsiderueshëm. Përgjatë gjithë periudhës së vlerësimit nuk ka kërkesa të pranuar për përjashtimin e gjyqtarit.

Propozohet lidhur me kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, pikët 100, niveli "Shkëlqyeshëm".

Për të kaluar tek “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”.

Gjyqtari shfaq komunikim të qartë dhe transparent. Respekton konfidencialitetin dhe mbron të dhënat personale të palëve për të cilët vihet në dijeni për shkak të funksionit. Për të dy këto komponentë propozohet nivel maksimal vlerësimi dhe pikëzimi.

Gjithashtu ka aftësi shumë të mira për të bashkëpunuar si në aspektin e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët ashtu edhe me administratën gjyqësore. Propozohet nivel shumë i lartë vlerësimi dhe pikëzimi.

Provohet gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari në Shkollën e Magjistraturës. Ka 14 aktivitete të zhvilluara për 20 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën trevjeçare. Propozohet pikëzimi me 20 ditë.

Po ashtu nuk provohet disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatë përgjatë stazhit profesional, pra nuk ka ushtruar cilësinë e mentoruesit. Pikëzohet me 3 pikë lidhur me këtë komponentë.

Gjyqtari ka provuar pjesëmarrjen e tij në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë në disa aktivitete trajnuese në të cilat (dhe mësimdhënëse) ka rol aktiv dhe referon dhe ka përgatitur gjithashtu dhe ...*(nuk kuptohet fjala)*. Propozohet niveli maksimal i vlerësimit dhe i pikëzimit.

Gjithashtu përgjatë periudhës së vlerësimit gjyqtari ka 7 publikime ligjore dhe akademike të botuara në revista shkencore të indeksuara.

Lidhur me publikimet ligjore dhe akademike propozohet niveli i vlerësimit me 5 pikë.

Kështu që, kriteri “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” për gjyqtarin {...} propozohet të jetë niveli "Shkëlqyeshëm", pikët 98.

Propozimi për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit të gjyqtarit propozohet të jetë "Shkëlqyeshëm", pikët 396.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Keni ndonjë pyetje?

Nëse nuk kemi diskutime mbi çështjen, kalojmë në votimin e saj. Ilir!

Ilir Rusi: Dakord.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Miratimin e raportit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për periudhën 2020-2022, duke e vlerësuar si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
- Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 11.07.2024)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për shfuqizimin e vendimit nr. 97, datë 29.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për pezullimin e procedimit disiplinor nr. 1/2024, të filluar ndaj magjistrates, znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë” dhe vijimin e shqyrtimit të tij”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relatore znj. Gentiana Muçaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 12:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Markelian Koça* (anëtar)

9. Yllka Rupa (anëtare)

10. Emona Muçi (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Irena Plaku**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Edmond Hoxhaj, Birn.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shfuqizimin e vendimit nr. 97, datë 29.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për pezullimin e procedimit disiplinor nr. 1/2024, të filluar ndaj magjistrates, znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë” dhe vijimin e shqyrtimit të tij”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relatore znj. Gentiana Muçaj).

Naureda Llagami: Atëherë kalojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës, e cila në fakt ka të bëjë me shfuqizimin e vendimit nr. 97, datë 29.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për pezullimin e procedimit disiplinor nr. 1/2024, të filluar ndaj magjistrates, znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë” dhe vijimin e shqyrtimit të tij.

Për më shumë detaje fjalën ia jap relatores znj. Gentiana Muçaj.

Gentiana Muçaj: Faleminderit Kryetare!

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me shkresën nr. {...} prot., datë 12.01.2024 ka depozituar për shqyrtim pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 16.01.2024, kërkesën me objekt “Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjstrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” ndaj magjstrates znj. {...} të parashikuar nga nenet 105, pika 1, shkronja “dh” dhe 111 të Ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar.

Pas depozitimit të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit, me vendimin nr. 29, datë 24.01.2024, Këshilli ka caktuar relatorin dhe ky vendim i është komunikuar edhe magjstrates dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Me vendimin nr. 39, datë 31.01.2024, mbi propozimin e relatorit të çështjes, Këshilli ka vendosur kalimin e çështjes në seancë dëgjimore, për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjstrates {...}, duke njoftuar rregullisht palët në zbatim të parashikimeve të nenit 138.

Magjistratja znj. {...} ushtronte funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhe ishte me status të pezulluar, referuar vendimit nr. 437 datë 10.09.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me anë të të cilit ka vendosur: “1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. {...}”. Nga verifikimi i faqes elektronike të Komisionit të Posaçëm të Apelit rezultoi se ankimi dhe vendimi i KPK-së ishin në proces shqyrtimi deri në vendimmarrje të Kolegjit të Posaçëm të Apelit regjistruar me çështje (JR) nr. 69/2021, datë 11.11.2021.

Në këto kushte, me vendimin nr. 97 datë 29.02.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

1. Pezullimin e procedimit disiplinor nr. 1/2024 të filluar ndaj magjstrates znj. {...}, deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. 437, datë 10.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Rezultoi se më datë 03.07.2024, Kolegji i Posaçëm i Apelit, pas shqyrtimit të ankimit ndaj vendimit nr. 437, datë 10.09.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 437, datë 10.09.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit {...}.

Në këto kushte, kur tashmë shkak i pezullimit të procedimit disiplinor ka rënë dhe nuk ekziston më, nga Komisioni Disiplinor vlerësohet se duhet të shfuqizohet vendimi i pezullimit dhe çështja të vijojë të trajtohet nga mbledhja plenare e cila do të duhet tashmë të zgjidhë çështjen në themel.

Sa sipër, Komisioni Disiplinor në mbledhjen e datës 08.07.2024 vendosi t'i parashtrojë mbledhjes plenare projekt vendimin për Shfuqizimin e vendimit nr. 97 datë 29.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ky projektvendim do ketë vetëm dy pika.

Në pikën e parë të projektvendimit propozohet shfuqizimi i vendimit nr. 97 datë 29.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë", deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. 437, datë 10.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; dhe ky vendim t'i njoftohet zonjës {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Naureda Llagami: Atëherë, faleminderit!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit meqë nuk kemi ndonjë diskutim.

Ilir!

Ilir Rusi: Dakord.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Disiplinës.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 11.07.2024)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 12:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Markelian Koça*** (anëtar)
9. ***Yllka Rupa*** (anëtare)
10. ***Emona Muçi*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Irena Plaku**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Edmond Hoxhaj, Birn.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Përpara se të kalojmë me dyer të mbyllura, kemi shtuar në rend dite një kërkesë nga një gjykatë në nevojë, është Gjykata e Shkallës së Parë Berat, e cila i ka bërë kërkesë KLGJ-së për plotësimin e një trupe gjyqësore. Kështu që, ftoj administratën që të marrë masat për hedhjen e shortit. Shkurtimisht fjalën ia jap kryetarit të Komisionit, z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë!

Paraqes relacionin e radhës që ka për objekt caktim gjyqtari në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

Deri më datë 10.07.2024, pranë KLGJ-së, është për trajtim kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, kërkesë e parashtruar nga

29

Zëvendëskryetarja në detyrë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, sipas të dhënave të mëposhtme.

Bëhet fjalë për tre çështje me natyrë penale. Për secilën nga këto tre çështje kërkohet plotësimi i trupit gjykues me nga një gjyqtar.

Çështja e parë është me natyrë penale dhe ka për objekt akuze veprën penale të “Vjedhjes së energjisë elektrike”. Numri i gjyqtarëve që kërkohet të caktohet është 1. Numri i kërkesës 638. Numri i çështjes 305. Kërkohet caktimi i një gjyqtari për formimin e trupit gjykues për gjykimin e themelit të çështjes; Gjyqtarit z. {...} i është pranuar kërkesa për heqje dorë; gjyqtarja znj.{...} ka qenë gjyqtare e hetimeve paraprake; gjyqtarja znj. {...} ka qenë gjyqtare e seancës paraprake dhe ka dhënë vendim për kalimin e çështjes në gjyq. Janë konsumuar të gjithë gjyqtarët kërkohet një gjyqtar për të gjykuar çështjen e themelit.

Çështja e dytë ka për objekt akuze veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”. Numri i gjyqtarëve që kërkohet të caktohet është 1. Numri i kërkesës është 819. Numri i çështjes është 379. Kërkohet caktimi i një gjyqtari për plotësimin e trupit gjykues për gjykimin e çështjes së themelit të përbërë nga gjyqtarët z. {...}, znj.{...}. Gjyqtarja zonja Çela ka pengesë pasi ka qenë gjyqtare në fazën e hetimit paraprak.

Çështja e tretë është çështje penale ka për objekt akuze veprën penale të “Vrasjes me dashje të mbetur në tentativë”. Numri i gjyqtarëve që kërkohet të caktohet është 1. Numri i çështjes është 267. Kërkohet caktimi i 1 gjyqtari për plotësimin e trupit gjykues për gjykimin e çështjes së themelit. Trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët z.{...}, znj. {...}, kjo e fundit e caktuar me vendim të Këshillit të lartë Gjyqësor. Gjyqtares znj. {...} i është pranuar kërkesa për heqje dorë.

Zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit dhe zbatimi i mekanizmit të përkohshëm të gjyqtarit bëhet i pamundur për t’u aplikuar në rastin konkret.

Ndodhur në këto kushte ne si Komision propozojmë që të vihet në zbatim mekanizmi i caktimit të gjyqtarit në gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ai ushtron funksionet në mënyrë të përhershme.

Propozimi mbështetet në nenin 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar si dhe në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë”.

Duke marrë në konsideratë kriteret e përcaktuara në paragrafin IV, pika 5, të Vendimit të KLGJ-së të përmendur më lart, si dhe në zbatim të paragrafit V, pika 4, të këtij vendimi, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 3.

Në opsionin e pranimit të propozimit të mësipërm, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon: Për 3 çështje, për të cilat kërkohet respektivisht nga 1 gjyqtar, të përzgjidhen me short 3 të tillë nga gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, seksioni penal.

Përfundimet nga shorti.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, referuar paragrafit VIII të Vendimit të KLGJ-së, propozon të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, znj. {...}; si dhe znj. {...} për shkak të pengesës ligjore që ka në çështjen me nr. rendor 3 në tabelë.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, të bëjmë lidhjen për pjesën e hedhjes së shortit.

Atëherë, të hidhet shorti, se administrata e bëri të mundur.

Vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për kërkesën e paraqitur me e-mailin e datës 9.07, gjyqtari i përzgjedhur Noel Veizi.

Për kërkesën nr. 819, gjyqtari i përzgjedhur Alfred Konomi.

Për kërkesën nr. 638, gjyqtari i përzgjedhur Vladimir Cjapi.

Naureda Llagami: Me kaq po e mbyllim mbledhjen, për të lejuar Këshillin me vijimin e çështjeve që zhvillohen me dyer të mbyllura.

Faleminderit!

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor